

URDHËR
Nr. 42, datë 20.1.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.3.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, të deleguara te zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta me urdhër të ministrit të Drejtësisë nr. 54, datë 6.2.2024, “Për autorizimin dhe delegimin e disa kompetencave/autoritetit të ministrit të Drejtësisë zëvendësministrit të Drejtësisë z.Klajd Karameta”, për periudhën 20.1.2025–24.1.2025, delegohen te zëvendësministri i Drejtësisë z.Tedi Dobi.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z.Tedi Dobi, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja